



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:040739

Datë: 26.09.2024

Numri i dokumentit: 06212764

**C.nr.277/22**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil**, gjyqtari Migjen Kastrati, në çështjen juridike kontestimore të paditësit, B.Sh nga Peja, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, Aurora Mulhaxha, avokate nga Peja, kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve ‘S.....’, me seli në Prishtinë, rr. ‘P.J nr....., baza juridike, për kompensim të dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 25,187.00 €, jashtë seancës gjyqësore me datën 26.09.2024, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA**

**I. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PA BAZUAR** kërkesëpadia e paditësit, B.Sh nga Peja, me të cilën ka kërkuar që të: **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e bazuar. **DETYROHET** e paditura K.S. ‘S’, që në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje të përmbartimit të dhunshëm, paditësit t’ia kompensoj shumën e parave prej 25,187.00 €, e deri në pagesën definitive, për shkak të dëmit për shkëputjen e kontratës në kundërshtim me ligjin. **DETYROHET** po ashtu e paditura, që paditësit t’ia kompensoj të gjitha shpenzimet e procedurës, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit, e nën kërcenim të ekzekutimit me dhunë.

### **A r s y e t i m**

Paditësi përmes të autorizuarës së tij në këtë gjykatë me datën 28.02.2022, ka parashtruar padi kundër të paditurës, nga baza juridike, kompensim dëmi material dhe jo material.

Me parashtresën e datës, 25.09.2024 të dorëzuar pranë kësaj gjykate, e autorizuar e paditësit avokate Aurora Mulhaxha nga Peja, ka potencuar se me këtë parashtresë heqë dorë nga kërkesëpadia, me arsyetimin se me të paditurën, Kompaninë e Sigurimeve kanë lidhur ujdi jashtëgjyqësore.

Me dispozitën e nenit, 149.1 të LPK-së, shprehimisht parashihet “Në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, heq dorë nga një pjesë e kërkesë padisë apo nga e gjithë kërkesëpadia gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykim në bazë të heqjes dorë)”, ndërsa me pikën 2, të po të njëjtit nen shprehimisht parashihet “Për heqje dorë nga kërkesëpadia nuk nevojitet pëlqimi i palës se paditur”.

Prandaj, duke pasur parasysh se e autorizuar e paditëses me parashtresën e datës, 25.09.2024, ka bërë tërheqjen nga kërkesëpadia, gjykata në mbështetje të dispozitës se nenit 149, lidhur me nenin 388, të LPK-së, gjeti se në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore që gjykata të bie aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2022:040739, C.nr.277/22, datë 26.09.2024**

**Gjyqtari**  
**Migjen Kastrati**

---

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181, paragrafi 2 i LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se heqja dorë nga kërkesëpadia është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.